

**AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BORIS TRAVEL 1411”**

Sot me date 25.06.2018, ne Tirane, Ortaku vetem themelues:

- 1. Znj. Matilda Ndoj**, e bija e Prenges, lindur ne Tirane, e datelindjes 26.06.1986 dhe me banim ne Tirane, Rr. Dritan Hoxha, shtetase shqiptare, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar, e identifikuar me leter njoftim nr. 032139543 dhe nr. personal I65626113C.

Ortaku si me siper i identifikuar deklaroi se ka vendosur te themeloje shoqerine “Boris Travel 1411” Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi si vijon.

**Neni 1
Emertimi**

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “BORIS TRAVEL 1411”

**Neni 2
Objekti**

Shoqeria ka per objekt:

Agjensi turistike, udhetimesh, shitje biletash ajrore detare dhe tokesore; shitje primi kompani sigurimesh; qiradhenie makinash.

Neni 3 SELIA

3.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Rr. Sulejman Delvina, kati perdhes, ndertesa nr. 6 pasuria nr. 2/327+1 –N6, Njesia administrative nr. 5- Tirane - Shqiperi.

3.2 Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojte filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

**Neni 4
Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin pa afat. Asamblea Ortakeve me vendim mund te vendose nje afat per kohezgjatjen e Shoqerise.

**Neni 5
Kapitali**



5.1 Kapitali i shoqërisë tregtare private “Boris Travel 1411” sh.p.k., do të jete 10.000 Leke (dhjetemije).

Kapitali në para është nënshkruar nga ortakët i vetëm themelues si vijon:

1. **Znj. Matilda Ndoj**, zotëuese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 (dhjetemije) Leke që përben 100% (njëqind për qind) të kapitalit themelues të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme/ të drejta).

5.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Administrimi

6.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm i emëruar nga Asambleja e Ortakëve.

Administratori i Shoqërisë është:

Znj. Matilda Ndoj, e bija e Prenges, lindur në Tiranë, e datelindjes 26.06.1986 dhe me banim në Tiranë, Rr. Dritan Hoxha, e identifikuar me leter njoftimi nr. 032139543 dhe nr. personal I65626113C.

Administratori emërohet për një periudhë 5 (pese) vjeçare me të drejtë riperteritje dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Ortakëve.

Administratori ka tagra të **pakufizuara**. Me titull thjeshtues por jo gjithëpërfshires, në mënyrë të veçantë ushtron këto tagra:

- administrojnë Shoqërinë në zbatim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e ortakëve;
- përfaqësojnë shoqërinë;
- emërojnë përfaqësues të përgjithshëm ose të posaçëm për çështje të veçanta dhe vendos mbi shkarkimin e tyre;
- kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë;
- për gatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, raportin mbi ecurinë e veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet në Asamblene e Ortakëve për miratim;
- kryen regjistrimet e detyrueshme të parashikuara nga regjistri tregtar;

- informon Asamblene e Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
- te emeroj financier e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare, tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore për aktivitetin e kryer nga shoqëria;
- te lidhi marrëveshje me te trete ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket;
- te shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues.
- te thërrasi asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave te përcaktuara ne ligj;
- te kryej veprime/tranzaksione ne llogarite rrjedhese te shoqerise me vlera te pakufizuara, perfshire nenshkrimin e kontratave me te trete.

6.2 Administrimi i shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve mund te behet dhe nga nje ose me shume administratore te cilet mund ta administrojne se bashku ose veçmas shoqerine sipas vendimit perkates te asamblese.

6.3 Administratori shkarkohet nga detyra nga asambleja e ortakeve ne rastet si me poshte:

- shkarkohet nga asambleja per shkak se nuk permbush detyrat qe i jane caktuar nga statuti dhe ligji, ben mungesa te pajustificuara per me shume se tre muaj ose nuk eshte me i afte per t'i permbushur ato;
- jep doreheqjen dhe j'a komunikon ate asamblese, jo me vone se 30 dite para dates se largimit.

Neni 7

Viti Financiar dhe Bilanci

7.1 Viti Financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht per vitin e themelimit te Shoqerise, viti financiar fillon nga data e themelimit deri me 31 Dhjetor 2018.

7.2 Ne rast prishje dhe likuidimi te Shoqerise, ne çdo moment dhe per çdo arsye, emerimi i likuidatorit do te miratohen me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Aratitaj
2018


Neni 8

Dispozitat e fundit

Ky akt-themelimi i shoqërisë “Boris Travel 1411” Sh.p.k., u hartua ne baze te vullnetit te lire te themelueses, ne mbështetje te dispozitave përkatëse te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “për tregtaret dhe shoqëritë tregtare “ i ndryshuar, dhe u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

Ortaku i Vetem themeluese

Znj. Matilda NDOJ

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The top signature is a cursive script that reads "Matilda NDOJ". Below it is a second, more stylized signature, also in blue ink, which appears to be "Matilda NDOJ" with a large flourish at the end.